



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Inspektion

Nr. 10 / 2026

NJOFTIM

Drejtoria për Inspektion njofton të gjithë qytetarët se ndalohet hedhja e mbeturinave përgjatë lumenjve, afër kanaleve të ujitjes, si dhe në afërsi të kanalit derivues furnizues me ujë të Liqenit të Radoniqit.

Çdo person që kapet duke hedhur mbeturina, qofshin ato inerte, organike apo mbeturina të tjera, do të përballet me masa ndëshkuese dhe gjoba për ndotje të mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Apelojmë tek të gjithë qytetarët që të kontribuojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe të raportojnë tek organet kompetente çdo rast të hedhjes së mbeturinave në hapësira publike dhe përgjatë rrjedhave ujore.

Po ashtu, kërkojmë bashkëpunim nga Stacioni Policor për koordinimin e aktiviteteve dhe veprimeve të përbashkëta në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimit të ndotjes.

Ruajtja e mjedisit është përgjegjësi e përbashkët.

